



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.57/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike të kandidatit për kryetar komune dhe të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal nga ky subjekt politik, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 26.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen si të bazuara ankesat e e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Nisma për Kosovën, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 500.00 (pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL. Anr. 57/2017, të datës 24.09.2017 dhe ZL. Anr. 62/2017 datë 25.09.2017 dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL. Anr. 57/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 24.09.2017 dhe 25.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankes nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe një ankes nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendohet se në rrugën Ahmet Kaqiku në Ferizaj gjegjësisht në hyrje të nënkalimit tek hekurudha e komunës është vendosur posteri i kandidatit për kryetar komune dhe i kandidatëve për asamble komunale të Ferizajt nga subjekti politik Nisma për Kosovë. Me këtë rast parashtruesit e ankesave theksojnë se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së.

Parashtruesit e ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 25.09.2017, subjekti politik Nisma për Kosovën, thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se këto janë vendosur gabimisht dhe pa qëllim nga aktivistët e tyre, dhe se me të njoftuar me ankesën kanë ndermar masat permisuese duke e larguar posterin nga vendi ku ka qene i vendosura. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterin nga vendi ku kanë qenë të vendosura ai.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

Ankesat janë të bazuara

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterin i kandidatit për kryetar komune dhe të anëtarëve për kuvend komunal nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën është vendosur në hapsira dhe në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Nisma për Kosovën, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterin i kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal dhe për kryetar komune nga subjekti politik Nisma për Kosovën, është vendosur në hapsira dhe në rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik Nisma për Kosovën në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Nisma për Kosovën, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterin i kandidatit për kryetar komune dhe të anëtarëve për kuvend komunal nga subjekti politik Nisma për Kosovën është vendosur në rrugë dhe në hapsira publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektin politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndermar veprime për të bërë permisimin e

shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL. Anr.57/2017 më datën 26.09.2017.



Kryesuesi i Panelit
Zyhra Haziri

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*